



RAPORT STUDIMOR

- SEANCAT
 - PUBLIKE
 - VETTINGU
- I Shkurt – Dhjetor 2019



RAPORT STUDIMOR

MBI MBARËVAJTJEN E SEANCAVE PUBLIKE TË PROCESIT TË VETTINGUT TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE

**Referuar monitorimit të seancave publike të zhvilluara në KPK dhe KPA gjatë periudhës
Shkurt – Dhjetor 2019**

Publikuar në dt. 27 Tetor 2020

Ky raport u përgatit nga Komitetit Shqiptar i Helsinkit (KShH) në kuadër të nismës “Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut - III”, projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga KShH. Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e KShH-së dhe ekspertëve që kanë kontribuar në hartimin e tij dhe jo domosdoshmërisht paraqet pikëpamjet e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA).



Përgatitën:

1. Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive e KShH-së
2. Znj. Malvina Dani, Eksperte ligjore

Kontribuuan në realizimin e raportit (sipas rendit alfabetik):

1. Znj. Albana Misja, Juriste
2. Znj. Dafina Hysa, Juriste/Gazetare
3. Znj. Iva Plaushku, Koordinatore Projekti/Juriste, KShH

Ekspertët vëzhgues të seancave gjyqësore publike të vettingut (sipas rendit alfabetik):

1. Z. Armand Sokoli, Avokat
2. Znj. Amilda Haxhiu, Avokate
3. Znj. Dafina Hysa, Juriste/Gazetare
4. Znj. Iva Plaushku, Juriste
5. Znj. Migena Kondo, Juriste
6. Znj. Sonila Kamami, Avokate

Konsulencë Ligjore:

1. Dr. Rainer Deville, Ekspert ligjor ndërkombëtar
2. Z. Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor, KShH

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-te, Pallati “Tekno Projekt”

Shk. 2 Ap. 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752

Tel: 04 2233671 / Mob: 0694075732

web site: www.ahc.org.al

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në këtë raport analizohen të dhënat statistikore si dhe cilësore të ecurisë së vettingut, bazuar në monitorimin e kryer nga vëzhguesit e KShH-së ndaj seancave publike të zhvilluara nga KPK dhe KPA por dhe monitorimin e faqeve të tyre zyrtare. Disa nga aspektet e analizuara në këtë raport kanë të bëjnë me shpeshtinë dhe dinamikën e procesit të vettingut, respektimin e aspekteve të parimit të procesit të rregullt ligjor bazuar në mbarëvajtjen e procesit në seancë dëgjimore, aksesin në informacionin publik dhe qasja lidhur me transparencën ndaj publikut nga ana e institucioneve të vettingut, etj.

Në aspektin e respektimit të parimeve të procesit të rregullt ligjor, vlen për t'u theksuar fakti, trupat gjykuese në KPK dhe KPA, janë të angazhuara në garantimin e të drejtave të subjekteve të rivlerësimit. Në përgjithësi, subjekteve, u është njohur e drejta, që të mbrohen personalisht, ose me avokat, që të dëgjohen lidhur me kërkesat dhe pretendimet e tyre në seancë dëgjimore, që të paraqesin provat, që i çmojnë të arsyeshme për bazueshmërinë e pretendimeve të tyre, etj.

Gjithashtu subjekteve u vihen në dispozicion aktet dhe rezultatet e hetimit administrativ, si dhe dosja e plotë përpara zhvillimit të seancës dëgjimore, në rastet kur ata e kërkojnë zyrtarisht. Mgjth, lidhur me raportet e DSIK si organ ndihmës në procesin e kontrollit të figurës, raportet e klasifikuara si sekret shtetëror, nuk u janë vendosur në dispozicion subjekteve, me përjashtim të rasteve kur informacioni deklasifikohet plotësisht, ose pjesërisht.

Është pozitiv fakti, se çdo seancë publike, njoftohet publikisht në faqen zyrtare të KPK-së dhe KPA-së. Njoftimi jep të dhëna, për orën dhe vendin ku do zhvillohet seanca si dhe për përbërjen e trupit gjykues. Vihet re se KPA i publikon seancat në mënyrë më të organizuar, pasi ato njoftohen të paktën një javë përpara datës së planifikuar. Ndërsa KPA, në shumë raste sidomos gjatë muajve të verës, ka publikuar seancat edhe rreth 24 orë nga zhvillimi i tyre.

Pjesëmarrja e publikut gjatë seancave publike të monitoruara nga vëzhguesit e KShH-së është garantuar nga KPK dhe KPA. Infrastruktura e KPK-së është lehtësisht e aksesueshme nga publiku, monitoruesit dhe mediat. Ndërsa seancat në KPA paraqesin vështirësi për t'u ndjekur nga publiku për arsye të sipërfaqes së vogël të sallës.

Lidhur me shkallën e publicitetit të procesit, në aspektin e informacionit që raportohet nga trupat gjykuese për subjektet, përjashtimisht, është konstatuar se për disa subjekte, KPK nuk ka prezantuar në seancë publike aktet provuese të hetimit dhe konkluzionet për kalimin e barrës së provës të subjekti i rivlerësimit. Mënyra se si raportohet metodologjia financiare e vlerësimit të kriterit pasuror të subjekteve shpesh herë paraqitet jo e plotë dhe jo e kuptueshme.

Veç aksesit për të ndjekur seancat publike, ligji u njeh qytetarëve të drejtën të paraqesin denoncimet e tyre ndaj subjekteve të rivlerësimit pranë organeve të vettingut. Numri i denoncimeve të qytetarëve në KPK gjatë vitit 2019 është 1857. Jo pak denoncime rezultojnë nga paraqiten nga qytetarët edhe pranë vëzhguesve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM). Gjatë seancave publike në KPK, vëzhguesit raportojnë se në mjaft raste, trupat gjykuese nuk i relatojnë denoncimet e mbërritura nga publiku, por mjaftohen vetëm me faktin e përmendjes nëse janë marrë në konsideratë, apo janë rrëzuar nga Komisioni.

Parimi i paanshmërisë së trupës gjykuese zbatohet gjerësisht, duke komunikuar, që në fillim të seancës, rastet e mundshme apo të dyshuara, të konfliktit të interesit. Subjekteve u njihet e drejta për të kërkuar përjashtimin e një anëtari apo disa anëtarëve, kur vlerëson se cenohen parimet e nenit 6 të KEDNJ, për një gjykim nga një gjykatë e paanshme. Në 4 prej seancave publike të monitoruara pranë KPK-së, subjektet e rivlerësimit kanë kërkuar përjashtim të një anëtari ose të trupit gjykues, por kërkesa është rrëzuar. Gjatë seancës pasardhëse, nuk është bërë me dije, edhe përbërja e trupit gjykues, që ka shqyrtuar kërkesën dhe ka marrë vendimin. Në një seancë publike të monitoruar pranë KPA-së, është vërejtur se shqyrtimi i kërkesës për përjashtim nga një trup gjykues, është marrë në shqyrtim nga trupi gjykues ku bënte pjesë edhe anëtari për të cilin kërkohej përjashtimi, duke vendosur në diskutim respektimin e procesit të rregullt ligjor.


1. Të dhëna mbi vendimmarrjen, dinamikën, transparencën e procesit të “Vettingut”

Teksa procesi ka hyrë në vitin e tretë të zbatimit të tij, evidencat statistikore, tregojnë se pritet të rivlerësohen në shkallë të parë rreth $\frac{3}{4}$ e subjekteve (gjyqtarë dhe prokurorë).

Nga data 8 shkurt 2018, kur daton vendimi i parë i KPK-së për ndërprerjen e vettingut, e deri në dhjetor të vitit 2019, kanë kaluar në filtrin e këtij institucioni, 221 subjekte. Vetëm 94 subjekte ose 42.5 % të totalit të të vettuarve, janë konfirmuar në detyrë. Nga subjektet që kanë marrë vendimin për të vijuar detyrën, 39 janë gjyqtarë, 46 prokurorë dhe 9 ndihmës ligjorë/kandidatë për magjistratë. Ndërsa 83 subjekte ose 37% të totalit të të vettuarve janë shkarkuar nga detyra, mes të cilëve 50 gjyqtarë, 31 prokurorë dhe 2 ndihmës ligjorë/kandidatë për magjistratë. Në 19 raste, KPK ka vendosur për ndërprerjen e procesit, në 8 raste të tjera pushimin e procesit, në 16 raste është vendosur përfundimi i procesit pa një vendim përfundimtar dhe në një rast, subjekti është pezulluar nga detyra për një periudhë 1-vjeçare.

Në fokus prioritar të veprimtarisë së institucioneve të vettingut kanë qenë përveç subjekteve prioritare që vetë ligji parashikon, edhe subjektet që kanë kandiduar për të qenë pjesë e Gjykatës dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë (për kandidatët që vijnë nga radhët e sistemit të drejtësisë).


Vendimet e KPK-së, 8 Shkurt 2018 – 31 Dhjetor 2019



Grafiku 1: Burim, <http://kpk.al/ep-content/uploads/2020/01/Raporti-shkurt-2018-dhjetor-2019-1.pdf>

1.1 Ecuria e procesit në KPK dhe KPA, për vitin 2019

Ritmi jo dinamik i procesit të vettingut, në mënyrë të veçantë vonesat në ngritjen e institucioneve të reja të drejtësisë (KLGJ, KLP dhe KED), si dhe vështirësitë e hasura në drejtim të gjetjes së kandidatëve të kualifikuar në këto institucione, kanë passjellë pamundësinë e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, duke krijuar kufizime në drejtim të aksesit të qytetarëve në organet e drejtësisë. Deri në fund të vitit 2019, Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë, nuk kanë qenë funksionale.



Grafiku 2: Vendimet e KPK-së

■ 19 gjyqtarë, 28 prokurorë, 5 ndihmës ligjorë
 ■ 28 gjyqtarë, 19 prokurorë, 1 këshilltar ligjor
 ■ 9 gjyqtarë, 3 prokurorë
 ■ Kuvendi i Inspektorëve dhe KED-së; 10 gjyqtarë, 1 prokurorë
 ■ Për pezullim nga detyra


Nga janari deri në dhjetor të 2019-ës, KPK ka rivlerësuar 129 subjekte, prej të cilëve, 52 prej tyre, ose 40.3 % e totalit të të rivlerësuarve, kanë kaluar me sukses sitën e “vettingut”. Konkretisht, janë vlerësuar pozitivisht për të trija kriteret, 19 gjyqtarë, 28 prokurorë dhe 5 ndihmës ligjorë. KPK ka shkarkuar nga

detyra 48 subjekte, duke vendosur në 12 raste për ndërprerje të procesit ¹, për 16 subjekte është vendosur përfundimi i procesit pa një vendim përfundimtar si dhe në një rast është vendosur pezullimi i subjektit nga detyra.

Për vitin 2019, KPA ka dhënë 34 vendime, nga të cilat, vetëm dy subjekte janë rikonfirmuar në detyrë (konkretisht për subjektet Nertina Kosova dhe Gentian Medja, për të cilët, Komisioneri Publik ka paraqitur ankim në KPA).

Të dhënat sasiore për dinamikën e seancave në KPK, gjatë periudhës Janar - Korrik 2019. Në këtë periudhë KPK ka zhvilluar 80 seanca publike. Ritëm i ngadaltë, është vërejtur edhe në pjesën e dytë të vitit 2019. Gjatë muajve Shtator – Tetor 2019, janë zhvilluar përkatësisht 5 dhe 7 seanca dëgjimore, ndërsa më pas vihet re një intensifikim i punës, duke kulmuar me 14 seanca dëgjimore gjatë muajit nëntor 2019.

Grafiku 3: Dinamika e seancave në KPA



Në total, për 2019-ën, KPA ka zhvilluar 96 seanca, prej të cilave 72 në seancë publike dhe 24 të tjera në dhomë këshillimi. Në KPA, mesatarja e gjykimit të seancave ka qenë rreth 6 seanca në muaj, ndërkohë që në muajin Korrik 2019 u vu re një rritje e numrit të seancave duke arritur deri në 14 të tilla.

Nisur nga të dhënat e mësipërme, konsiderojmë se procesi ka vijuar me ritme të ngadalta edhe përgjatë vitit 2019, referuar numrit të subjekteve të rivlerësuara dhe shpeshtësisë së seancave publike, veçanërisht pranë KPK-së, përbërja e së cilës mundëson krijimin e katër trupave gjykuese.

1.2 Vendimet e KPK-së, pa vendim përfundimtar

Gjatë vitit 2019, KPK ka vendosur për 16 subjekte përfundimin e procesit pa një vendim përfundimtar, përkatësisht për 10 gjyqtarë, 5 prokurorë dhe për ish kryeinspektoren e KLD-së.

¹ Aneks i Kushtetutës; Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve; Neni G Dorëheqja 1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose 6 prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

Në fakt një vendimmarrje e tillë, nuk parashikohet në asnjë dispozitat e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Vendimet që mund të marrë KPK në shkallë të parë, janë konfirmim, pezullim dhe shkarkim nga detyra ².

Precedenti i parë, pa një vendimmarrje përfundimtare nga KPK është për ish Kryeinspektoren e KLD-së, vendim i cili u publikua i arsyetuar pas 52 ditësh. Në këtë vendimmarrje, KPK argumentoi se objekti për të cilin ka nisur procedura, është bërë i pamundur, pasi subjekti e ka humbur statusin e gjyqtarit. Më herët, për këtë subjekt, KPK kreu hetim të thelluar administrativ në të treja kriteret, proces që mori 14 muaj kohë përgatitore. Vendimi u shoqërua edhe me mendimin e pakicës, sipas të cilit përfundimi i shumicës se subjekti është në kushtet e mungesës së statusit të gjyqtarit, nuk gjen mbështetje në kuptim të parashikimeve ligjore. KShH ka vlerësuar edhe më herët se mendimet paralele apo në pakicë janë tregues i pavarësisë së jashtme dhe të brendshme të institucioneve të vettingut, gjë që i shërben debatit të shëndetshëm ligjor midis anëtarëve si dhe kontribuon në drejtim të përmirësimit të cilësisë së arsytimit të një vendimi³.

Pas vendimit të përmendur më sipër, subjekti i rivlerësimit u ankua pranë KPA-së, por më pas e tërhoqi ankimin. Në dhomë këshillimi, KPA vendosi me shumicë votash, pushimin e shqyrtimit të çështjes, për shkak të tërheqjes së ankimit.

1.3 Transparenca e organeve të vettingut për njoftimin publik të seancave

KPK dhe KPA e ushtrojnë veprimtarinë e tyre, ndër të tjerash mbi bazën e parimit të transparencës. Nga monitorimet e kryera nga KShH, është konstatuar se ky parim është respektuar në të shumtën e rasteve.

Data, vendi, dhe ora e zhvillimit të seancave publike pranë KPK-së dhe KPA-së, si edhe vendimet përfundimtare të këtyre dy institucioneve, u janë njoftuar subjekteve pjesëmarrëse dhe publikut në tërësi, nëpërmjet publikimit në faqet e tyre zyrtare (rubrikat përkatëse). Transparenca i mundëson publikut mbikqyrje si aktorë të jashtëm, por tepër të rëndësishëm, në krijimin e besueshmërisë lidhur me këtë proces të vështirë dhe me peshë në pastrimin e sistemit tonë të drejtësisë.

² Ligji nr.84/2016 “Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Masat disiplinore 58/1. Në përfundim të procesit, Komisioni mund të vendosë për subjektet e rivlerësimit: a) konfirmimin në detyrë; b) pezullim nga detyra për një periudhë 1-vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës; c) shkarkimin nga detyra;

³“Qëndrimi në pakicë në vendimmarrjen e gjykatave”, Erind Mërkuri; https://www.academia.edu/31090519/Qendrimi_ne_pakice_ne_vendimmarrjen_e_gjykatave

Seancat publike të monitoruara vërehet se janë të hapura për ti mundësuar pjesëmarrjen publikut të interesuar. Medias po ashtu, i është krijuar hapësira e nevojshme, për ndjekjen e proceseve. Në KPK, kamerat e medias lejohen të regjistrojnë vetëm gjatë çeljes së seancës dëgjimore, ndërkohë pas këtij momenti gazetarët kanë mundësinë të përcjellin informacion vetëm përmes mesazheve telefonike.

Që në çelje të seancës, kryesuesi i trupit gjykues, i kushton rëndësi parashtrimin në formë shteruese të të gjitha të drejtave procedurale, të parashikuara për subjektin e rivlerësimit përgjatë gjithë fazës së hetimit administrativ, si edhe të drejtave lidhur me zhvillimin e seancës.

Rrethanat e faktit dhe rezultatet e hetimit administrativ, paraqiten nga relatori i çështjes. Mgjth, nga seancat publike të monitoruara në KPK vërehet se ka patur raste të mosrelatimit në mënyrë të plotë apo qoftë edhe të pjesshme, të disa rezultateve me interes për publikun që ka prodhuar hetimi administrativ dhe veçanërisht të lidhura me denoncimet e qytetarëve. Edhe pse subjekti rezulton se është informuar paraprakisht për këto rezultate⁴, relatimi i tyre në mënyrë sa më të plotë (duke u ndalur tek ato me rëndësi dhe interes për publikun) do ti shërbente transparencës dhe besimit më të mirë të publikut në këtë proces. Gjithashtu, në relatimin e fakteve evidentohet nevoja për të patur një qartësi më të mirë në mënyrën se si është kryer analiza financiare (metodologjia). Konkretisht, vëzhguesit e KShH-së referojnë se për subjektet R.P; A.M; D.S, nuk janë relatuar në mënyrë transparente apo të plotë, aktet e hetimit dhe konkluzionet, ku janë bazuar anëtarët e trupit gjykues në kalimin e barrës së provës subjektivit të rivlerësimit.

Në disa raste, gjatë relatimit në seancë publike, nuk janë bënë të ditura rezultatet e hetimit administrativ lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, pa specifikuar nëse mosrelatimi lidhet me faktin e të klasifikuarit të tyre ose jo si sekret shtetëror. Mgjth, ka dhe raste si ai i subjektivit F.P, i cili i kërkoi KPK-së deklasifikimin e informacionit të DSIK-së, kërkesë e cila u pranua dhe u mundësua vendosia në dispozicion e raportit ndaj subjektivit.

Gjithashtu, kemi mendimin se në funksion të transparencës së procesit ndaj publikut, pretendimet që shpalosen nga subjekti apo avokati i tij/saj mbrojtës mund të marrin një kohë më të arsyeshme⁵. Kjo qasje në fakt kërkon një barazpeshë me parimin e ekonomicitetit të procesit gjyqësor.

⁴ Në të gjitha seancat publike të monitoruara nga KShH, subjektet kanë pohuar se u është dhënë e drejta e njohjes me dosjen, janë vënë në dijeni me rezultatet e hetimit, kanë shfrytëzuar të drejtën për të paraqitur shpjegime në lidhje me këto rezultate.

⁵ Vëzhguesit raportojnë raste kur subjekti i rivlerësimit paraqet pretendimet e tij, lidhur me rezultatet e hetimit, ndërkohë që nga kryesuesi i trupit gjykues, i sugjerohet “të mos kalojë në përsëritje”, por të ndalet vetëm tek argumentet dhe provat e reja, duke theksuar se trupi gjykues i ka marrë argumentat dhe provat me shkrim”.

1.4 Vonesat në shpalljen/arsyetimin e vendimeve

Mosshpallja e vendimit në fund të seancës dëgjimore, është kthyer tashmë një praktikë nga organet e “vettingut” për shumicën e vendimmarrjeve të monitoruara. Vëzhguesit e KShH-së raportojnë se shpallja e vendimeve bëhet kryesisht nga 2 deri në 7 ditë pas zhvillimit të seancës dëgjimore, ndërkohë që ligji nr. 84/2016, parashikon shprehimisht shpalljen e vendimit në fund të seancës dëgjimore⁶. Kështu, për disa subjekte, mes të cilëve D.P; E.H; P.Ç; A.M; KPK ka shtyrë më shumë se një herë komunikimin e shpalljes së vendimit, pa dhënë një arsyetim të shkaqeve që justifikojnë shtyrjen.

Vonesat janë evidente edhe në zbardhjen e vendimeve nga KPK dhe KPA. Në pjesën dërrmuese të vendimeve nga KPK-së nuk është respektuar afati ligjor prej 30 ditësh, për publikimin e vendimit të arsyetuar⁷. Janë vënë re raste kur zbardhja e vendimeve ka marrë deri në tre apo katër muaj kohë për KPK-në, veçanërisht për vendimet e shpallura gjatë muajve Qershor – Korrik 2019. Gjithashtu evidentohen raste, si psh; për subjektin L.H, që procesi nga seanca dëgjimore e deri në zbardhjen e vendimit, ka marrë gjysmë viti kohë⁸.

Përtej konsideratës së punës voluminoze që kanë organet e vettingut, KShH vëren se publikimi në kohë i vendimeve të arsyetuara garanton transparencën dhe nuk cenon aktualitetin e vendimmarrjes në sytë e opinionit publik (për të interesuarit), konform dhe afateve ligjore.

2. Bashkëpunimi dhe përfshirja e publikut në procesin e vettingut

Nga seancat e monitoruara nga KShH, është konstatuar pjesëmarrje aktive e qytetarëve në denoncimin e rrethanave dhe fakteve, të pretenduara si kompromentuese për pastërtinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve të lidhura me një ose më shumë kriter. Është pozitiv fakti se këto denoncime kanë shërbyer si indicie për institucionet e vettingut, për të thelluar më tej hetimin e pavarur administrativ. Gjatë vitit 2019, janë referuar pranë KPK-së një total prej 1857 denoncimesh, ku numrin më të lartë e shënojnë ato të bëra në periudhën Prill – Maj 2019.

⁶ Ligji Nr. 84/2016 Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. *Neni 55/6. Vendimi shpallet në fund të seancës dëgjimore.*

⁷Ligji Nr. 84/2016; *Neni 55/7. Vendimi me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit.*

⁸ Konkretisht seanca dëgjimore për subjektin L.H, është zhvilluar me datë 27.05.2019, vendimi është shpallur me 26.06.2019, ndërsa u është njoftuar palëve dhe është publikuar në faqen zyrtare të KPK-së, me 12.11.2019.



Grafik 4. Denoncimet e publikut, referuar të dhënave në regjistrin e KPK-së

Referuar të dhënave të vëzhguesve që kanë monitoruar seancat publike, pjesa më e madhe e denoncimeve i përketin qytetarëve që kanë qënë palë në proces dhe që pretendojnë se janë dëmtuar nga vendimmarrja e padrejtë e subjekteve ose e trupave gjyquese ku kanë qënë pjesë.

Krahasuar me seancat e fillimit të procesit të vettingut, vëzhguesit e KShH-së raportojnë me një qasje më pozitive nga KPK dhe KPA, sa i përket bërjes publike të ankimeve/denoncimeve të ardhura nga qytetarët. Megjithatë, edhe për këtë pjesë të procesit vijon të ketë çështje që nga pikëpamja e transparencës mund të adresohen më mirë, të analizuara në vijim të raportit⁹.

Në seancat e monitoruara pranë KPK-së vërehet se denoncimet e publikut janë refuzuar ose nuk kanë passjellë evidentimin e shkeljeve për një ose më shumë kritere rivlerësimi të subjekteve, në rastet kur denoncimi i adresohet çështjeve që i përketin palëve ndërgjyqëse që kanë humbur procesin gjyqësor (psh kur i referohen zgjidhjes në themel të çështjeve gjyqësore), ose kur subjekti ka qënë në pakicë në vendimin gjyqësor, ose për çështje për të cilat është bërë rekurs dhe janë në shqyrtim pranë Gjykatës së Lartë, etj.

Vëzhguesit evidentojnë raste kur denoncimet e publikut pranë KPK-së kanë sjellë konstatimin prej tyre të shkeljeve nga ana e subjekteve të rivlerësimit dhe në disa raste edhe shkarkimin e tyre. Kështu, për subjektin D.S, denoncimet e publikut lidhur me aftësitë profesionale janë marrë në konsideratë nga KPK dhe në vlerësimin përfundimtar është çmuar se subjekti gëzon nivel minimal të njohurive profesionale. Për subjektin H.D dhe A.Ç, denoncimet e paraqitura nga publiku kanë kontribuar në vendimmarrjen e KPK-së për shkarkimin e tyre, me arsyetimin ndër të tjera të cënimit të besimit të publikut. Nga ana tjetër, ka patur edhe seanca kur relatorët e trupës janë mjaftuar vetëm me bërjen publike të numrit të denoncimeve por pa parashtruar të dhëna qoftë edhe në mënyrë të përmbledhur, mbi objektin e tyre apo për arsyet e mosmarrjes së

⁹ Vlen të theksohet rasti i subjektit R.P, që megjithëse kishte 11 denoncime nga publiku ato u vlerësuan se nuk u gjetën fakte të besueshme, të cilat mund të cenonin punën dhe aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit në kuptim të pikës 4, të nenit 43, të Ligjit nr.84/2016 “Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

këtyre denoncimeve në konsideratë. Ose për seancat e monitoruara për subjektin R.P, që megjithëse në adresë të subjektit kishte 11 denoncime nga publiku, ato u vlerësuan nga KPK se nuk evidentonin fakte të besueshme, të cilat mund të cenonin punën dhe aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Megjithatë theksojmë se qasja e KPK-së për të bërë transparente natyrën e denoncimeve, të paktën tek subjekti i rivlerësimit apo mbrojtësi i tij/saj, duke i kaluar barrën e provës, si dhe duke i përfshirë si materiale në dosjen e çështjes, është një element pozitiv, që mbron të drejtën e subjekteve për t'u mbrojtur dhe për të marrë dënim për çdo pretendim kundër tyre.

Në përfundim, KShH vlerëson se pavarësisht trendit pozitiv, sërisht ka nevojë për një elaborim më të mirë të praktikës së organeve të vettingut, në drejtim të transparencës së denoncimeve (pa cenuar të dhënat e denoncuesve), relatimit të objektit dhe natyrës së tyre, thellimit të hetimit administrativ për denoncime që kanë peshë ose sinjalizojnë fakte dhe të dhëna të rëndësishme në kuadër të procesit të rivlerësimit, relatimit gjatë seancës të faktit nëse denoncimet janë marrë ose jo në konsideratë dhe nëse janë refuzuar, për cilat arsye, etj.

2.1 Natyra e denoncimeve të publikut

Nga seancat e monitoruara gjatë vitit 2019, rezulton se objekt i denoncimeve të publikut ka qënë kryesisht shpërdorimi i detyrës nga subjektet e rivlerësimit dhe aftësitë e dobëta profesionale, shkelje e rregullave procedurale të sanksionuara në Kodet Procedurale.

Një pjesë e konsiderueshme e denoncimeve adresohen për subjektet prokuror dhe natyra e denoncimeve ka të bëjë me fazën hetimore, mosrespektimin e afateve hetimore, zvarritjen e qëllimshme të procedimit penal, pushimin e padrejtë të çështjes penale, pretendime për akte të natyrës korruptive, mosveprim për kallëzimet penale, shkelje etike profesionale, qëndrim i njëanshëm dhe paaftësi në procesin penal, mosushtrim rekursi, ngritje e akuzës padrejtësisht, etj.

Për subjektet me status gjyqtar, natyra e denoncimeve lidhet më së shumti me vendimet gjyqësore të padrejta, si dhe janë administruar denoncime të tjera për paaftësi profesionale, ndikim të paligjshëm me natyrë politike në vendimmarrje apo akte të tjera të natyrës korruptive, shtyrje e pajustificuar e seancave gjyqësore, zvarritje procesi, favorizim i të pandehurit çka ka sjellë edhe rikthimin e tij në kryerjen e krimeve më të rënda, kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me palët ndërgjyqëse, vonesa për dorëzimin e dosjeve në sekretari, etj. Vlen të evidentohen edhe raste të denoncimit të vetë kolegëve gjyqtarë, për kontakte të subjektit me një person të përfshirë në trafik lëndësh narkotike dhe evazion fiskal. Gjithashtu, qytetarët kanë adresuar edhe shkelje të rregullave të etikës apo situata paligjshmërie jashtë marrëdhënieve të funksionit si gjyqtar.

3. Respektimi i dinjitetit njerëzor të subjekteve të rivlerësimit

Nga monitorimet e seancave dëgjimore pranë KPK-së, gjatë vitit 2019, është konstatuar se etika e sjelljes së trupit gjykues ndaj subjekteve apo avokatëve mbrojtës, përgjatë gjithë ecurisë së zhvillimit të seancës është paraqitur e rregullt. Nga ana tjetër, qëndrimet e subjekteve të rivlerësimit paraqiten në përgjithësi korrekte dhe bashkëpunuese me KPK-në, duke iu përgjigjur kërkesave për plotësimin e dokumentave provues në rastin e kalimit të barrës së provës, etj.

Mbetet pozitiv fakti se përgjithësisht nuk janë shfaqur tendenca deklarative në sjellje apo në administrimin e provave nga anëtarë të trupit gjykues, për të lehtësuar apo rënduar pozitën e subjektit të rivlerësimit dhe nuk janë konstatuar sjellje të papërshtashme apo njëanshmëri në procesin e marrjes në pyetje. Megjithatë në raste përjashtimore, është vlerësuar si sugjestionuese këmbëngulja e relatorit, i cili bëri disa pyetje, që në thelb dukej se kërkonin konfirmim për dyshimet e tij¹⁰.

Ka patur raste, në seancat e monitoruara, kur një anëtar i trupit gjykues ka vlerësuar se ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit dhe ka paraqitur kërkesën për heqjen dorë nga procesi. Në rastet kur subjekti kërkon përjashtimin e një anëtari apo të gjithë trupit gjykues, me pretendimin për qëndrim të njëanshëm apo gjendje të konfliktit të interesit, KPK nuk bën publike përbërjen e trupit gjykues, që ka shqyrtuar kërkesën. Vendimi shpallet në seancën e radhës, nga trupi gjykues, por pa dhënë detaje. Vlerësojmë se kjo praktikë, nuk i shërben transparencës së procesit.

Edhe për seancat e monitoruara në KPA, vëzhguesit e KShH-së raportojnë për sjellje etike dhe solemne nga anëtarët e trupit gjykues ndaj subjekteve të rivlerësimit. Marrja në shqyrtim e kërkesave të subjekteve për papajtueshmëri apo konflikt interesi me detyrën të anëtarëve të trupës gjykuese, komunikohet paraprakisht në kalendarin e seancave të publikuar në faqen zyrtare të internetit, duke përcaktuar datën, orën, vendin dhe përbërjen e trupës që do e shqyrtojë. Për subjektin e rivlerësimit A. B, është depozituar kërkesë nga ana e saj me objekt përjashtimin e një prej anëtarëve të trupit gjykues, me pretenimin për njëanshmeri në gjykim. Kjo kërkesë u rrëzua, por subjekti ka pretenduar se nuk i është dhënë akses në vendimin e ndërmjetëm për refuzimin e kërkesës. Praktikë e ngjashme vërehet edhe për subjektin e rivlerësimit I.M, i cili kërkoj në seancë përjashtimin e relatores. Vlen të theksohet se subjektit të rivlerësimit dhe të pranishmëve në seancën dëgjimore nuk iu vu në dispozicion vendimi i ndërmjetëm megjithë kërkesën e subjektit.

4. Aksesi në seancat publike

Vëzhguesit e KShH-së kanë monitoruar mbi 100 seanca publike të zhvilluara nga KPK dhe KPA, përgjatë të cilave nuk është konstatuar tendencë për të penguar pjesëmarrjen e publikut të

¹⁰ Subjekti I rivlerësimit D.P.

interesuar. Data, të dhënat orientuese lidhur me çështjen (subjektin dhe trupën gjyquese) dhe vendndodhja e zhvillimit të seancave publikohen rregullisht dhe paraprakisht në kalendarët që askesohen lehtësisht në faqet zyrtare të këtyre institucioneve. Megjithatë duhet të theksojmë se në shumë raste, KPK ka pasur tendencën për të publikuar seancat dëgjimore rreth 24 orë nga zhvillimi i tyre, kryesisht gjatë muajve Qershor dhe Korrik 2019. Kjo praktikë e cila vështirëson pjesëmarrjen e publikut dhe monitoruesve (si KShH) në seancë, ka sjellë edhe ankesa të disa subjekteve për këtë procedurë, duke pretenduar se nuk kanë pasur kohë të njihen me rezultatet e hetimit¹¹.

KPA i njofton publikisht të dhënat lidhur me zhvillimin e seancave publike, në afate më të arsyeshme, deri në shtatë ditë përpara.

Vëzhguesit e KShH-së raportojnë se kushtet teknike të sallës ku zhvillohen seancat publike të KPK-së, janë në standartet optimale, sa i përket infrastrukturës, aksesit pamor dhe dëgjimor gjatë procesit. Hapësira që rezervon kjo sallë, është e bollshme për të mundësuar pjesëmarrjen e një numri të konsiderueshëm të interesuarish. Distanca e vendosura për qëndrimin e palëve, dhe ndihma me mjete mikrofonike, mundëson respektimin e konfidencialitetit dhe privatësisë së komunikimit mes subjektit të rivleresimit dhe përfaqësuesit ligjor, i ofron përfaqësuesit ndërkombëtar pamje dhe monitorim të plotë të procesit. Me kërkesën e tyre, pjesëmarrësit pajisjen me kufje nga stafi që mundëson përkthimin e ndërhyrjeve të vëzhguesve të ONM-së. Ndërsa, përsa i përket KPA-së, lidhur me infrastrukturën e sallës së gjykimit, nuk mundësohen të njëjtat standarte. Hapësira që rezervon e vetmja sallë ku zhvillohen seancat publike, është e pamjaftueshme për të mundësuar pjesëmarrje të një numri të konsiderueshëm subjektësh dhe medias. Distanca e vendosur për qëndrimin e palëve, cënon konfidencialitetin dhe privatësinë e komunikimit mes subjektit të rivleresimit dhe përfaqësuesit ligjor. Në disa raste, kjo infrastrukturë (për shkak të kapaciteteve të kufizuara) nuk i ka mundësuar çdo të interesuari ta ndjekë atë nga radhët e publikut.

KPK dhe KPA kanë miratuar në kuadër të veprimtarisë së tyre, akte nënligjore të posaçme, me natyrë rregullatore, për aksesin dhe pjesëmarrjen e mediave në seancat publike. Kështu, vendimi i KPK-së nr.18, dt. 13.03.2018 “Për miratimin e dokumentit “Rregullore për mediat”, përkatësisht në nenin 3.1 parashikon se: “*Seancat dëgjimore të KPK-së janë publike dhe mund të ndiqen nga gazetarët*”. Dispozita vijon më tej duke përcaktuar procedura të detajuara të aksesit të mediave në seancë, herë lejuese, kur parashikohet se: “*Gazetarëve u lejohet të dërgojnë mesazhe në format teksti nga celularët e tyre gjatë zhvillimit të seancës; Gazetarëve u jepet mundësia të bëjnë fotografi përpara zhvillimit të seancës dëgjimore;*” por edhe kufizuese kur parashikohet se: “*Kryesuesi i trupës së KPK-së mund të vendosë që t’i lejohet hyrja në sallën e seancës vetëm një numri të kufizuar grupesh regjistrimi me kamera; Nuk lejohet të regjistrohen as me zë dhe as me*

¹¹ Subjekti I.M është shprehur se dy ditë përpara zhvillimit të seancës dëgjimore kishte depozituar prova me një material voluminoz dhe për KPK-në ka qenë i pamundur vlerësimi i tyre në më pak se 72 orë nga marrja në dorëzim. Ky pretendim u përforcua edhe nga avokatja mbrojtëse e subjektit.

figurë subjekti i rivlerësimit, përfaqësuesi” etj. Masat kufizuese në këtë rregullore janë të diskutueshme sa i takon respektimit lirisë së medias, transparencës dhe karakterit publik të procesit.

Ndërkohë, KPA ka miratuar rregulloren “Për marrëdhëniet me mediat”, miratuar nga mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin nr. 11/1, datë, 13.04.2018. Në përmbajtjen e saj përfshihet neni 3, i cili afirmon karakterin publik të procesit¹². Por më tej, në pikën 9, janë parashikuar kufizime për regjistrimin nga ana e mediave¹³. Pra, konstatojmë të njëjtat rregullime të natyrës kufizuese, në të dyja rregulloret e KPK-së dhe KPA-së. Kufizime të tilla, të parashikuara në të dy rregulloret e përmendura nuk gjenden në ligjet kuadër¹⁴ që normojnë veprimtarinë e këtyre institucioneve, të cilat janë miratuar me shumicë të cilësuar dhe renditen në nivel më të lartë hierarkik krahasuar me këto akte rregullatore me karakter normativ.

Në tërësi, KShH vlerëson si pozitiv publicitetin e seancave, sjelljen e stafit përgjegjës për akomodimin dhe sistemimin e publikut në sallë, sjelljen e trupit gjykues karshi parimit të publicitetit, askesin e plotë që vëzhguesit e KShH-së kanë patur përgjatë gjithë procesit të monitorimit gjatë vitit 2019, si në seancat publike të KPK-së dhe ato të KPA-së.

3.1 Veprimet përgatitore gjatë seancave publike

Vëzhguesit e KShH-së kanë vërejtur se në veprimet përgatitore në seancën publike që paraprijnë seancën dëgjimore janë zhvilluar në mënyrë të rregullt nga trupat gjykuese të KPK-së dhe KPA-së, të cilat kanë bërë me dije të drejtat procedurale që gëzon subjekti i rivlerësimit, është komunikuar njohja e tyre me dosjen e plotë hetimore si dhe rezultatet e hetimit administrativ, në afat të arsyeshëm për të realizuar në mbrojtje efektive, etj.

Pas çeljes së seancës publike, referuar nenit 55, të Ligjit nr.84/2016, komunikohet përbërja e trupit gjykues dhe i jepet mundësia subjektit të rivlerësimit të referojë publikisht gjeneralitetet dhe funksionin përkatës për identifikim. Kryetari i trupit gjykues, konfirmon gjatë veprimeve përgatitore të drejtat procedurale të subjektit të rivlerësimit, që janë zbatuar gjatë hetimit administrativ, si: e drejta për tu njohur me rezultatet përfundimtare të hetimit administrativ dhe dokumentacionin e administruar në dosje, e drejta për të kundërshtuar gjetjet e KPK-së; për të

¹² *Seancat gjyqësore pranë Kolegjit janë të hapura për mediat”*

¹³ *“Mediat lejohen të bëjnë regjistrime (vizuale) të hyrjes në sallë të trupit gjykues dhe të çeljes së seancës nga kryesuesi i trupit gjykues. Më pas, kamerat dhe mikrofonët fiken dhe nxirren jashtë sallës ku zhvillohet seanca gjyqësore.”*

¹⁴ Dispozitat e Ligji pwr Gjykatat Administrative dhe Kodit tw Procedurws Civile, tw cilat nuk bien ndesh por janw nw harmoni me dispozitat e Ligjit nr.84/2016 “Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pwr bwjnw kuadrin ligjor bazw qw sanksionon procedurwn e zhvillimit tw seancave publike dhe aspekte tw tjera procedurale pwr gjatw procesit¹⁴.

paraqitur prova, për të paraqitur shpjegime në formë zyrtare, për të refuzuar dhënien e përgjigjes, etj.

3.2 E drejta e subjektit për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar

Monitorimet e seancave publike kanë evidentuar se e drejta për tu mbrojtur, si një aspekt i rëndësishëm i parimit të procesit të rregullt ligjor (neni 6 i KEDNJ; neni 42 i Kushtetutës), më së shumti janë respektuar nga trupat gjykuese të KPK-së dhe KPA-së.

E drejta për tu mbrojtur kërkon që mbrojtja të jetë efektive dhe jo formale, si psh aksesi i plotë në materialet e dosjes hetimore të realizuar nga organet e vettingut dhe organet ndihmëse, afati i arsyeshëm për të përgatitur mbrojtjen, e drejta për të paraqitur prova në mbrojtje të pretendimeve të subjektit, etj.

Në disa raste, subjektet kanë pretenduar se materialet e dosjes nuk i janë vendosur të gjitha në dispozicion, si psh analiza financiare, raportet e DSIK ose kanë kundërshtuar afatin që ju është lënë në dispozicion nga trupa gjykuese të KPK-së për të përgatitur mbrojtjen, i cili sipas monitorimeve të realizuara nga KShH varion nga 5 deri në 15 ditë. Në një tjetër rast, subjekti pretendoi se një pjesë e dokumenteve i janë dorëzuar, vetëm pasi ka paraqitur me shkrim pretendimet e tij. Nga subjektet janë shfaqur edhe ankesa, si psh për refuzim kërkesë për administrimin në cilësinë e provës të marrjes së një dëshmie, vetëm një ditë para zhvillimit të seancës dëgjimore.

Nga monitorimet e realizuara subjektet janë shprehur lirisht për pretendimet e tyre në seancën dëgjimore dhe nuk janë refuzuar të përfitojnë nga e drejta për të mos u përgjigjur, në përputhje me pikën 3 të nenit 55 të ligjit 84/2016. Pavarësisht, se institucionet rivlerësuese kanë tagrin ligjor për të kufizuar kohën për t'u shprehur nga ana e subjektit të rivlerësimit, në përputhje me pikën 4 të nenit 55 të ligjit 84/2016, sërish në çdo seancë subjektit të rivlerësimit i është dhënë fjala për të parashtruar qëndrimin e tij. Megjithatë, ndonëse të rralla, ka pasur raste kur subjektit i është kufizuar koha, ose i është kërkuar nga drejtuesi i seancës, të paraqesë vetëm faktet të reja dhe të anashkalojë ato që ka dorëzuar me shkrim më herët para KPK-së.

3.3 Riçelja e hetimit administrativ

Procedura e riçeljes së hetimit administrativ gjatë shqyrtimit në KPK është një praktikë jo e shpeshtë dhe është arsyetuar kryesisht me dhënien e mundësisë subjektit të rivlerësimit për të siguruar provat dhe aktet që justifikojnë pretendimet dhe gjetjet e KPK-së, në rastin e kalimit të barrës së provës. Monitorimi i seancave dëgjimore ka reflektuar se gjatë vitit 2019 është rihapur hetimi gjyqësor për katër subjekte. KPK ka arsyetuar rihapjen e hetimit gjyqësor, me faktin, se

për disa subjekte, që kanë një eksperiencë të gjatë pune, përbën vështirësi sigurimi brenda një kohe të shkurtër i dokumentave, që datojnë 20-30 vite më parë.

Nga ana tjetër në KPA, është vlerësuar marrja e provave të reja për të cilat, subjektit gjatë shqyrtimit të çështjes në KPK nuk i është kaluar barra e provës (për subjektet XH.Z; A.M; A.L).

3.4 Ri-vlerësimi mbi nje, dy apo tre kriteret

Nga monitorimet e kryera përgjatë vitit 2019, KShH ka konstatuar, që në disa raste hetimi administrativ është shtrirë vetëm në dy kriteret, përkatësisht, në atë të pasurisë dhe figurës. Rrjedhimisht dhe vendimmarrja e organeve të vettingut është kufizuar në këto kriteret. Kjo praktikë është vërejtur në seancat e monitoruara ndaj disa subjekteve si A.Gj; F.L; A.Z. Ndërsa subjekti E.A, është rivlerësuar për kriterin e pasurisë dhe aftësisë profesionale.

Kjo praktikë, e cila është mbështetur nga organet e vettingut në nenin 4, pika 2 të ligjit nr.84/2016, është analizuar edhe në raportet e mëparshme studimore të KShH-së si dhe në Kapitullin I të këtij raporti studimor.

Veçanërisht sa i takon hetimi administrativ, KShH vëren se në mënyrë që të jetë sa më gjithëpërfshirës, i bazuar në një qasje të unifikuar dhe që garanton barazi midis subjekteve si dhe në funksion të parimit të transparencës ndaj publikut, duhet të shtrihet mbi të tre kriteret tek të cilat bazohet procesi i vettingut (pasuria, figura dhe aftësitë profesionale). Gjithashtu, në vlerësimin tonë, aneksi Ç i Kushtetutës parashikon kërkon kryerjen e rivlerësimit në të treja kriteret¹⁵.

3.5 Pasuria, kriteri më penalizues

Ashtu si në konkluzionet e pasqyruara më herët gjatë studimit të vendimmarrjes së organeve të vettingut (pasqyruar në Kapitullin I), edhe monitorimet e seancave publike të vettingut, përgjatë 2019 evidentojnë se mosjustifikimi i pasurisë është shkak kryesor, që ka ndërprerë karrierën e gjyqtarëve dhe prokurorëve të shkarkuar nga organet e vettingut.

Monitorimi i seancave evidenton gjithashtu nevojën për të unifikuar metodologjinë financiare të ndjekur për rivlerësimin e kriterit të pasurisë. Vëzhguesit raportojnë se në disa raste, metodologjia e ndjekur dhe relatuar në seancë publike paraqitet jo e plotë dhe jo e kuptueshme, por mbi të gjitha është e pastandardizuar.

Mungesa e përcaktimit të qartë ligjor, se çfarë përqindjeje e pasurisë së pajustificuar, nuk do të përbënte shkak për vlerësimin negativ në kriterin e pasurisë, ka sjellë qëndrime e vendimmarrje

¹⁵Aneksi Ç i Kushtetutës; Neni Ç/1. Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij Aneksi dhe ligjit.

të ndryshme të Komisionit, madje edhe brenda të njëjtit trup gjykues. Ne rastin e subjektit R.H, të konfirmuar me shumicë votash në KPK, vendimi paraqet edhe mendimin e komisionerit kundër. Anëtari L.H argumenton: “Nuk pajtohem me vendimin e marrë nga kolegët e shumicës..... për shkak se subjekti i rivlerësimit, sipas meje, nuk arriti një nivel të besueshëm në rivlerësimin e pasurisë”¹⁶.

Gjatë seancave të monitoruara vihet re, se në mungesë të minimumit jetik të përcaktuar me ligj, Komisioni bën vlerësimin duke përdorur metodologji të cilat për nga mënyrat se si relatohen nuk vlerësohen nga vëzhguesit si të unifikuara. Shqipëria rezulton i vetmi vend në Evropë që nuk ka të përcaktuar zyrtarisht minimumin jetik, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme nga institucioni i Avokatit të Populli, sindikata dhe organizma të tjera jo-qeveritare.

Në një rast në Kolegj, subjekti i rivlerësimit A.M, i kërkoi trupit gjykues kryerjen e një analize të re financiare nga një ekspert kontabël i pavarur, për të mundësuar zhvillimin e një procesi në kushtet e paanësisë, duke iu referuar nenit 65, të ligjit 84/2016, neneve 47, 48, pika 1; 49, 51, dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 për gjykatat administrative. Trupi gjykues i KPA-së vendosi të rrëzojë kërkesën e tij, duke e çmuar të panevojshme, bazuar në nenin 49, pika 6, germa “a” të ligjit 84/2016. Një vendimmarrje e tillë, mund të krijojë premisë për intepretim, si një sjellje për të mos hetuar në mënyrë gjithëpërfshirëse kriterin pasuror të subjektit.

3.6 Natyra e shkeljeve të konstatuara në kuadër të vlerësimit të kritereve

Përgjatë monitorimit të seancave publike, vëzhguesit e KShH-së kanë raportuar edhe natyrën e shkeljeve, të kategorizuara dhe analizuara veçmas për secilin kriter në këtë pjesë të raportit studimor. Vlen të theksojmë se këto shkelje kanë rezultuar përgjatë hetimit administrativ të realizuar nga trupat gjykuese të KPK-së.

Shkeljet tipike për kriterin e Pasurisë:

- mungesë përputhshmërie në raportimin e pasurisë dhe burimit të krijimit të saj, midis të dhënave të pasqyruara në deklaratat periodike vjetore pranë ILDKPKI-së me ato të raportuara nga subjekti në deklaratën “vetting”,
- burim i paligjshëm i të ardhurave,
- fshehje e të ardhurave apo shpenzimeve,
- mosdeklarim i burimit të fitimit të pasurisë, përdorim i dokumentave jo të rregullta për ta provuar atë, deklarim i rremë ose mosjustifikim i të ardhurave për fitimin e pasurisë së subjektit apo personave të lidhur me të,

¹⁶<https://kpk.al/wp-content/uploads/2019/09/Mendim-pakice-Regleta-Panajoti.pdf>

- mosrespektim i legjislacionit për regjistrimin e pasurisë së luajtshme/të paluajtshme,
- çmimi i blerjes së apartamentit është më i ulët se çmimi i tregut ose kontrata fiktive dhe blerje me çmim fiktiv,
- të ardhurat e përfituara nga emigracioni, janë të pamjaftueshme për të justifikuar shpenzimet,
- përfitim i statusit si i pastrehë, në kundërshtim me ligjin ose në mënyrë të pajustificuar,
- mosdeklarim periodik mbi huanë,
- mosderdhja në mënyrë të plotë e sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi të ardhurat personale,
- pamundësi në likuiditete,
- mbajtja në tejkalim të pragut ligjor të gjendjes cash (në të holla) jashtë sistemit bankar, etj

Shkeljet tipike për kriterin e Figurës:

- konflikt interesi i subjektit me shtetas ndaj të cilëve janë ngritur akuza penale si pastrim i produkteve të veprës penale (neni 287 i KP), ndërtim i paligjshëm (neni 199/a i KP), etj,
- dyshimet bazuar në të dhënat e besueshme për përfshirjen e subjektit në veprën penale të korrupsionit pasiv,
- përdorimi i automjetit të shtetasit të dënuar për “trafik lëndësh narkotike” në Greqi, etj.

Shkeljet tipike për kriterin e Aftësisë Profesionale:

- mangësi në njohuritë ligjore, aftësitë e interpretimit dhe respektimit të ligjit,
- mangësi në arsyetimin ligjor,
- mangësi në cilësitë etike, angazhimin profesional dhe aftësitë organizative,
- zvarritje apo vonesa në ndjekjen e detyrave (funksionit),
- zgjidhje jo të drejtë ndaj praktikave të ndryshme,
- ka marrë masë disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit,
- konflikt interesi apo premisa për njëanshmëri me subjektet në çështjet e hetuara/gjykuara.

5. Vonesat përgjatë procesit

Në disa raste, vëzhguesit e KShH-së kanë konstatuar tejzgjatje të procesit, në gjykimet e zhvilluara pranë KPA-së, si për rastin e subjektit A.B, mbi 6 muaj proces gjyqësor (filluar më 13 dhjetor- dhe përfunduar në dt. 9 Korrik 2019, shpallja e vendimit). Shtyrje të njëpasnjëshme të seancave janë konstatuar edhe për subjektin e rivlerësimit, E. I. Procesi ka filluar në KPA, më 12.11.2018 dhe shqyrtimi gjyqësor është mbyllur më 17.04.2019, pas 12 seancash dëgjimore, ndërsa vendimi është marrë me 22 maj të vitit 2019.

6. Transparenca dhe roli i vëzhguesve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit

Vëzhguesit ndërkombëtarë në procesin e “vetting”, luajnë rol të rëndësishëm monitorues, por jo vendimarrës apo ndikues në aspekte të tjera të qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Gjatë monitorimit të seancave publike, vëzhguesit e KShH-së e kanë cilësuar kontributin e vëzhguesve të ONM-së si profesional, konstruktiv dhe kontribues (por jo diktues) në procesin e vettingut.

Megjithatë, në raste sporadike, roli dhe kontributi i vëzhguesve të ONM-së ka shkuar përtej kompetencave të tyre të parashikuar në nenin B, pika 3/b e aneksit Kushtetutës¹⁷. Kështu, në një rast të monitoruar, vëzhguesi i ONM-së, i dha subjektit disa këshilla lidhur me menaxhimin efikas të burimeve në gjykata në të ardhmen, për të shmangur vonesat në gjykim. Roli dhe detyrat që Kushtetuta dhe ligji nr.84/2016 i ka kanë dhënë vëzhguesve të ONM-së janë të kufizuara vetëm me procesin e rivlerësimit dhe mbarëvajtjen e tij, por jo me aspekte të tjera të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, siç është menaxhimi i burimeve njerëzore në të ardhmen, kompetencë e organeve të reja qeverisëse të gjyqësorit.

Neni 55 pika 3 e Ligjit nr.84/2016 “Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, parashikon të drejtën e vëzhguesit ndërkombëtar për t’i drejtuar pyetje subjektit gjatë seancës dëgjimore. Nënvizojmë se Në këtë mënyrë vëzhguesi ndërkombëtar ka tejkaluar kompetencat e tij.

Në një rast tjetër, mes subjektit dhe përfaqësuesit të ONM-së, pati replika në lidhje me huanë prej 5 milionë lekësh, marrë një të njohuri të familjes si edhe për ngjarjen e vitit 1997, në gjykatën e Gjirokastrës. Vëzhguesi i ONM-së ngriti pikëpyetje mbi këtë ngjarje, duke i kujtuar se nuk është detyra e gjyqtarit të bëjë “kaubojsin”. Këto mënyra të shprehuri konsiderohen jo etike për vetë seriozitetin dhe solemnitetin që ky proces ka përcjellë tek publiku.

Sa i takon vlerësimit të figurës së subjekteve të rivlerësimit është evidentuar në disa raste, se gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar për subjektin O.N, kanë shtyrë Komisionin t’i vlerësojnë ato dhe të kërkojnë rihapjen e shqyrtimit gjyqësor.¹⁸

Ka patur çështje, për të cilat opinioni dhe gjetjet e vëzhguesit të ONM mbështeten tek denoncimet e publikut, të paraqitura drejtpërsëdrejti nga qytetarët pranë ONM-së. Kështu, për rastin e subjektit D.P, vëzhguesi i ONM-së ka paraqitur opinion dhe gjetje për një denoncim të

¹⁷ Sipas kësaj dispozite, “Vëzhguesi ndërkombëtar paraqet gjetje dhe mendime, mbi çështje që shqyrtohen nga KPK dhe KPA, si edhe kontribuon për kontrollin e figurës sipas nenit DH”.

¹⁸ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 117 datë 21.03.2019

depozituar pranë ONM-së, i cili i ka shërbyer KPK-së kur ka vendosur transferimin pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore.¹⁹

Një aspekt i diskutueshëm sa i takon kotnributit të deritanishëm të ONM-së në procesin e vettingut është mendimi ndryshe i vëzhguesve të ONM-së, për vendimmarrje të organeve të vettingut. Në vlerësimin e KShH-së, mendimi paralel/ndryshe i paraqitur nga vëzhguesi i ONM-së mbi vendimin e KPA-së është i diskutueshëm pasi tejkalon atributet e përcaktuara në nenin “B” të Aneksit të Kushtetutës. Vëzhguesit e ONM-së kanë një rol pro-aktiv përgjatë gjithë procedurës së “vettingut” dhe jo pasi ky proces ka përfunduar me vendim të formës së prerë.²⁰

7. Roli i Institucionit të Komisionerit Publik

Edhe pse nuk ka qenë në fokus të drejtpërdrejtë të monitorimit të vëzhguesve të KShH-së, përgjatë procesit të vettingut është vërejtur se ankimet e Komisionerit publik i kanë shërbyer konsolidimit të praktikës së organeve të vettingut por edhe detajimit të aspekteve të rëndësishme të këtij procesi, për të cilat trupat gjykuese të KPK-së nuk kanë ndjekur metodologji të njëjtë nga përkamja e analizës së kriterit të pasurisë apo atij të aftësive profesionale.

Ndaj subjektit të rivlerësimit G.M, Komisioneri Publik ka luajtur një rol aktiv në krijimin e një precedenti pozitiv në praktikën e vettingut, duke i kërkuar Kolegjit përcaktimin e një metodologjie vlerësimi për kriterin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit bazuar në indikatorët dhe nën-indikatorët sipas kërkesave të ligjit Nr.96/2016.

8. Rekomandime

Rekomandimet drejtuar institucioneve të vettingut i përkasin gjetjeve dhe sfidave të identifikuara në të dy kapitujt e parë të këtij raporti studimor, për shkak të ngjashmërisë së gjetjeve dhe konkluzioneve të çështjeve të monitoruara (si në aspektin e vendimmarrjes por edhe të seancave publike të KPK-së dhe KPA-së), por gjithashtu edhe duke e vlerësuar procesin e vettingut si një proces të vetëm dhe unik, pavarësisht hallkave përbërëse të tij.

Rekomandimi 1: I sugjerojmë KPK-së dhe KPA-së të përshpejtojnë me ritme dinamike zhvillimin e seancave publike për subjektet e rivlerësimit dhe të caktojnë prioritete në punën e tyre në drejtim të kategorizimit të subjekteve që do të vetohen në periudhë afatshkurtër (si psh subjektet që kanë kandiduar në Gjykatën e Posaçme, Prokurorinë e Posaçme, Gjykatën e Lartë, etj). Në mënyrë të veçantë, KShH vëren se pranë KPK-së do të ishte i nevojshëm një angazhim

¹⁹ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 112, datë 04.03.2019.

²⁰ Deklarata e E.Skëndaj, mbi opinionet paralele/ndryshe <http://www.ahc.org.al/nje-precedent-i-gabuar-mendimi-ndryshe-paralel-i-vezhguesit-nderkombetar-per-ceshtjen-ndaj-subjektit-a-sevdarit/>

më dinamik në trupa paralele të anëtarëve, por që nuk krijojnë mbivendosje përgjatë një jave kalendarike.

Për shkak të rëndësisë dhe vëllimit të procesit të vetingut, i cili parashikon rivlerësimin kalimtar të rreth 800 subjekteve, KShH është në dijeni se ky proces është kompleks dhe i vështirë. Megjithatë, KShH gjykon se ky volum i lartë pune kërkon veprimtari me ritëm më të shpejtë dhe më dinamik nga institucionet e pavarura kushtetuese të vetingut, pa ndikuar cilësinë e procesit të vetingut.

Rekomandimi 2: I sugjerojmë Kuvendit të rishikohet struktura dhe organika e personelit të institucioneve të vetingut, me qëllim që ti përgjigjet ngarkesës reale të këtyre institucioneve.

Rekomandimi 3: I sugjerojmë institucioneve të vetingut të sigurojnë transparencë të plotë në seancat dëgjimore dhe vendimmarrjet e tyre, për disa nga aspektet e procesit të analizuara në këtë raport (si metodologjia e vlerësimit të kriterit pasuror, denoncimet e publikut, rezultatet e hetimit administrativ për të trija kriteret, rekomandimet e vëzhguesve të ONM-së, etj). Vëzhgimi dhe aksesimi i publikut dhe i medias në seancat dëgjimore duhet të vijojë konform standardeve pozitive të vendosura në praktikën e deritanishme të institucioneve të vetingut.

Rekomandimi 4: Sugjerojmë të rishikohet në Rregulloret e KPK-së dhe KPAsë për marrëdhëniet me median, kufizimi që është vendosur për regjistrimin audio-viziv pas çeljes së seancës dëgjimore, i cili në vlerësimin tonë nuk është në përputhje me kërkesat e lirisë së shprehjes të sanksionuar në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Kushtetutën e RSH-së.

Rekomandimi 5: Sugjerojmë që institucionet e vetingut të realizojnë një komunikim pro-aktiv me qytetarët dhe ti informojnë ato mbi ecurinë e shqyrtimit të denoncimeve të tyre. Gjithashtu, kemi mendimin se ankesat e qytetarëve të lidhura me themelin e çështjeve të hetuara dhe të gjykuara kërkojnë një hetim më të thelluar dhe gjithëpërfshirës për të evidentuar, shkelje ose jo të indikatorëve dhe nënindikatorëve të kriterit të aftësive profesionale në mënyrë të veçantë. I sugjerojmë KPA-së të publikojnë mbi baza periodike numrin e rasteve të denoncimeve të publikut të administruara dhe të shqyrtuara prej tij.

Rekomandimi 6: I sugjerojmë organeve të vetingut të publikojnë në faqet e internetit të dhëna statistikore periodike dhe të përditësuara, për numrin e subjekteve dhe rezultatet e procesit në mënyrë periodike.

Rekomandimi 7: I sugjerojmë trupave gjyqese të KPK-së që në përfundim të hetimit administrativ, të vendosin në dispozicion të subjekteve të rivlerësimit një afat sa më të arsyeshëm dhe të orientuar drejt standartizimit (unifikimit) për të paraqitur prova shtesë, komente, shpjegime dhe mendime rreth tyre (si p.sh. minimalisht 10 ditë).